



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E EKONOMISË, KULTURËS DHE INOVACIONIT
KËSHILLI KOMBËTAR I TRASHËGIMISË KULTURORE MATERIALE

Nr. 485 Prot.

Tiranë, më datë 18.10.2024

VENDIM
Nr. 429, datë 18.10.2024

Në mbështetje të Ligjit Nr. 27, datë 17.05.2018 “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, neni 38, pika 2, V.K.M Nr. 208, datë 10.04.2019 “Për Përbërjen, Mënyrën e funksionimit, Kompetencat dhe Shpërblimin e Anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale”, Urdhërit Nr. 223, datë 03.07.2020 “Për miratimin e rregullores për veprimtarinë e Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale, Këshillit Teknik, Sekretarisë Teknike dhe Sportelit Unik të Saj”, pas shqyrtimit më parë të projektit në Këshillin Teknik, Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale, në mbledhjen e datës 18.10.2024:

VENDOSI:

1. Miratimin e relacionit mbi komentet e UNESCO-ICOMOS në kuadër të projektit “Menaxhimi i qëndrueshëm dhe Masterplani i Vlerësimit të Turizmit të Kalasë së Gjirokastrës”, miratuar me Vendim Nr. 126 datë 31.05.2024 të KKTKM-së, **i hartuar nga DMK/IKTK;**
2. Të vijojë hartimi i Projekt - zbatimit për paketat 1 dhe 4, sipas komenteve të ICOMOS;
3. Pjesë e hartimit të projektit duhet të jetë edhe Raporti i Vlerësimit të Ndikimit në Trashëgimi;
4. Projekti të përcillet për mendim teknik në UNESCO;
5. Ngarkohet Instituti Kombëtar i Regjistrimit të Trashëgimisë Kulturore për regjistrimin e këtij vendimi;
6. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi;
7. Kundër këtij vendimi mund të ushtrohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni. Ankimi nuk pezullon zbatimin e aktit administrativ.

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETAR
Sokol ISMAILI

